



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
ZYRA ME NJË NDALESË**

Nr. _____ Prot.

Maliq, më: ____/____/2019

Procesverbal

I mbajtur në dëgjuesën publike për Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, në Njësinë Maliq/Qendër..

Në kuadër të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit 119/2014, “Për të drejtën e informimit publik”, dhe Ligjit nr. 146/2014, neni 18 “Pjesëmarrja në takime Publike”, u mbajt sot, më dt.12.09.2018, ora 14:00 në sallën e mbledhjeve të Njesisë Maliq/Qendër, takimi konsultativ (dëgjesa publike) mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, si dhe për buxhetin vjetor, pjesë e buxhetit afatmesëm.

Në takim morën pjesë : Kryetari i Bashkisë Maliq, z.Gëzim Topçiu , drejtues të strukturave të Bashkisë Maliq, banorë të Njesisë Maliq/Qendër, kryetarë të Fshatrave ,përfaqësues të bizneseve, shoqatave ,si dhe grupe e tjera të interesit.

Në vijim të procesit të hartimit dhe përgatitjes së Programit-Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2019-2021, dhe për buxhetin vjetor 2019, takuam dhe dëgjuam banorët e Njesisë Maliq/Qendër , për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve reale, që do të realizohen nga Bashkia Maliq, me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat, ku këta banorë jetojnë. Gjatë diskutimit, në thelb të dëgjësave publike ishin, jo vetëm punët dhe investimet e kryera nga Bashkia Maliq gjatë këtyre tre viteve, por dhe kërkesave e nevojave thelbësore në lidhje me përmirësimin e një sërë shërbimesh si ç’janë:

1. Ndërtimi i një palestere në Shkollën e Mesme “Skënderbeu” , Maliq.
2. Rehabilitimi dhe sistemimi i pjesës së Bibifikimit.
3. Rehabilitimi i disa fasadave të pallateve në bllokun nr. 1.
4. Ndërhyrja në riparimin e rrugës , në bllokun nr. 2.
6. U hodh idea për ndërtimin e një unaze brenda qytetit.
7. Në bllokun nr. 2 , pucetat e ujërave të zeza janë të bllokuara, të ndëryhet.
- 8.. Ndërhyrja në riparimin e rrugës , në bllokun nr. 3, rruga, Evropa dhe lart.
9. Problem mbetet dhe legalizimi i shtëpive në këtë zonë.
10. Një shqetësim tjetër mbetet dhe rrethimi i pallatev në bllokun nr. 3.
11. Uji i pijshëm mbetet problem në lagjen Qesaratë.
12. Kërkohet ndërhyrja për pastrimin e një kanali që është lënë përgjysëm, në lagjen Qesaratë.

13. Problem mbetet rruga e fshatit Kolanec, dhe hapja e rezervuarit për të vaditur.

14. Në bllokun nr. 4 , u kërkua vazhdimi i rehabilitimit të fasadave të pallatev dhe krijimi i një qendre rehabilitimi për grup-moshat e treta.ër grup-moshat e treta.

Theksi u vendos dhe tek përmirësimi i disa objekteve ,si kopshte ,shkolla ,furnizimi me dru zjarri etj. Takimi u hap me fjalën e Kryetarit të Bashkisë Maliq, e cila u pasua me prezantimin e Programit Buxhetior për periudhën 2019-2021, u bë një analizë e investimeve dhe punëve që janë kryer nga Bashkia Maliq gjatë kësaj periudhe, si dhe u propozua hedhja e ideve dhe mendimeve të banorëve të komunitetit për të përcaktuar prioritetet e investimeve dhe alokimin e fondeve sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit. Pas prezantimit u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilëve i'u përgjigjën drejtues dhe specialistë të Bashkisë që mbulojnë sektorët përkatës.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Stiljan Belishta